



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 31001-01961-00-2012 i Regj. Themeltar  
Nr. 00 - 2017 - 121 i Vendimit ( 67 )**

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Ardian Dvorani	Kryesues
Arjana Fullani	Anëtare
Evelina Qirjako	Anëtare
Andi Çeliku	Anëtar
Medi Bici	Anëtar

në seancë gjyqësore të datës 21.02.2017, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**PADITËSE:** *\*\*\*, përfaqësuar nga avokate \*\*\*.*

**TË PADITUR:** **Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave,**  
*në mungesë.*  
**\*\*\* shpk, në mungesë.**

**OBJEKTI:** Shpalljen e pavlefshmërisë relative të aktit administrative, Vendimit nr. **\*\*\***, datë 23.07.2010 të Bordit të Apelimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, për shkak se është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material. Ndryshimin e këtij vendimi, duke vendosur refuzimin e rregjistrimit të aplikimit nr. **\*\*\*** që i përket markës së publikuar “Turbo Energy Drink”, (& figura e demit e vijëzuar me të kuqe). Sigurimin e padisë, në formën e pezullimit të procedurës së regjistrimit të markës së publikuar “TURBO ENERGY DRINK”, (& figura e demit e vijëzuar me të kuqe), deri në përfundim të gjykimit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 324/a e vijues, dhe 348 të K.Pr.Civile, nenet 143 paragrafi 2, pika b dhe c si dhe 153 paragrafi 4 i Ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, neni 115, paragrafi 1, pika b e K.Pr.Administrative.

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin nr. **\*\*\***, datë **\*\*\***, ka vendosur:**

- Rrëzimin e padisë së palës paditëse \*\*\*.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.

**Gjykata e Apelit Tiranë**, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*, ka vendosur:

-Lënien në fuqi të Vendimit nr. \*\*\*, dt. \*\*\*, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka paraqitur *Rekurs pala paditëse* \*\*\***, që kërkon ndryshimin e të dyja vendimeve gjyqësore, duke vendosur pranimin e padisë, *duke parashtruar këto shkaqe*:

-Në lidhje me kërkesat tona për moszbatimin nga ana e Bordit të Apelimeve të parashikimeve të nenit 143 (2)(c) të ligjit të sipërcituar, evidentuam disa problematika të gjykimit në procedurën administrative të mbajtur përpara Bordit të Apelimeve të DPPM, ku me kryesore ishte ai i qëndrimit shumë të paqartë të Bordit të Apelimeve në lidhje me çështjen e njohjes së markës sonë si të mirënjohur.

-Në kundërshtuar në gjykate këtë qëndrim shumë të paqartë të Bordit të Apelimeve në lidhje me këtë çështje, duke parashtruar se në të dy rastet si në rastin e shmangies nga të ekzaminuarit të statusit tone si marke të mirënjohur, apo atë të njohjes së këtij statusi, por të mospranimit të ankimit tone për mungesë të mundësisë për konfuzion, Bordi i Apelimeve në të dy rastet nuk ka aplikuar parashikimet e dispozitës 143(2) (c) të ligjit “Për pronësinë industriale”.

-Gjykata e pranon statusin tone si marke të mirënjohur, gjithsesi ajo konkludon se në nuk ishim në gjendje të provonim që Bordi i Apelimeve nuk ka zbatuar dispozitën 143(2) (c) të ligjit “Për pronësinë industriale”, pasi paditësi - thotë gjykata- nuk provoi situatën e marrjes së përfitimeve të padrejta, pasi ai nuk depozitoi asnjë provë që të provonte uljen e shitjeve apo fitimeve të tij si pasojë e futjes në treg të markës së kundërshtuar.

Ky qëndrim është i gabuar pasi:

-**Së pari**, koncepti i marrjes së përfitimeve të padrejta nuk është një situatë që mund të provohet me uljen e shitjeve apo fitimeve.

-**Së dyti**, Uljet e shitjeve apo fitimeve nuk kanë të bëjnë me marrjen e përfitimeve të padrejta që marka e kundërshtuar merr nga marka me reputacion. Ulja e shitjeve dhe fitimeve është një situatë shumë me komplekse se kaq, ku ndikojnë një sërë faktorësh jo të lidhur me çështjen konkrete.

-**Së treti**, Gjate procesit vete pala e paditur ka pohuar që marka e kontestuar nuk është hedhur akoma në treg dhe për pasojë kjo është një tjetër argument që provon se konkludimi i gjykatës është i gabuar.

-Marka e kontestuar përmban figurën e demit dhe vetëm kaq do t’i mjaftonte Bordit të Apelimeve dhe Gjykatës për të konkluduar se marka e kontestuar do të dëmtojte karakterin dallues të markës apo reputacionin e markës së mirënjohur Red Bull.

-Analiza e gjykatës është e dobët, madje me e dobët nga ajo e bere nga Bordi i Apelimeve të DPPM. Gjykata nuk bën një analizë të gjithë treguesve, siç mund të ishte krahasimi vizual, konceptual, ngjashmëria në mallra, shkalla e vëmendjes së konsumatoreve etj, fuqia dalluese e markës dhe reputacioni i saj dhe me pas të konkludonte duke vendosur nëse ka apo jo mundësi për konfuzion, por vetëm flet në terma të përgjithshëm.

-Figura e Demit është një nga karakteret dallues të markave të paditësit. Për shkak të popullaritetit të lartë, paditësi gëzon të drejtën ekskluzive në përdorimin e këtij elementi në lidhje me pijet energjike.

Kërkesat tona i mbështetëm në dy argumentat ligjorë që ishin (I). Akti administrative i kontestuar është marrë në aplikim të gabuar të dispozitës 143 (2) (c) të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”; si dhe (II). ai është pasojë e mosanalizimit të saktë të rrethanave të faktit, rrethana këto që parashikohen në nenin 143 (2) (b) të ligjit të sipërpërmendur. Kërkesat tona i mbështetëm gjithashtu në parashikimet e nenit 115 (b) të Kodit të Procedurës Civile, të cilat përcaktojnë situatat kur një akt administrative mund të konsiderohet relativisht i pavlefshëm. Duke mbajtur parasysh të gjitha këto, ankimuesi (padiësi) kërkoi nga të dyja gjykatat shpalljen e këtij akti administrative të pavlefshëm.

Në lidhje me kërkesat tona për moszbatimin nga ana e Bordit të Apelimeve të parashikimeve të nenit 143 (2) (c) të ligjit të sipërcituar - dispozitë kjo që ka të bëjë me mbrojtjen që u ofrohet markave të mirënjohura- ne provuam përpara të dyjave gjykatave një pafundësi gabimesh bërë nga Bordi i Apelimeve, ku ata më të rëndat ishin; qëndrimi shumë i paqartë i Bordit të Apelimeve të DPPM në lidhje me çështjen e statusit tonë si markës e mirënjohur, si dhe faktin se në analizën e Bordit të Apelimeve të DPPM nuk ishim ekzaminuar aspak situata të parashikuara në dispozitën e sipërcituar. Shkurtimisht, ne provuam përpara gjykatave, se ne pa të drejtë u privuam nga mbrojta e ofruar nga neni 143 (2) (c) të ligjit “Për Pronësinë Industriale”.

Gjatë gjykimeve të mbajtura përpara të dyjave gjykatave u provua se ne kishim paraqitur përpara Bordit të Apelimeve të DPPM prova përkatëse të pakundërshtueshme për të provuar statusin tone si markë e mirënjohur, si dhe kishim mbështetur kundërshtimin tone ndaj regjistrimit të markës TURBO Energy Drink, midis të tjerash, dhe në parashikimet e nenit 143 (2) (c) të Ligjit “Për Pronësinë Industriale”. Konkretisht, në dosjen gjyqësore u administruar dosja e procedurës administrative të zhvilluar në DPPM në të cilën gjenden këto prova.

Sollëm në vëmendjen e Gjykatës qëndrimin e paqartë të Bordit të Apelimeve të DPPM në lidhje me kërkesën e ankimuesit (padiësit) për tu njohur si markë e mirënjohur, ku Bordi i Apelimeve të DPPM nga njëra anë anashkalonte të ekzaminuarit e statusit tonë si markë e mirënjohur duke thënë se “Nuk është e nevojshme të provohet se markat e kundërshtuesit janë të mirënjohura dhe për këto arsye gëzojnë një të drejtë të mëparshme”, pasi markat e kundërshtuesit janë të rregjistruara në territorin Shqiptar dhe kanë një datë depozitim më të hershme se data e depozitimit të markës që kundërshtohet.”, dhe nga ana tjetër pohonte se nuk ekziston mundësia që regjistrimi dhe përdorimi i markës së kundërshtuar të çojë në shfrytëzimin e padrejtë të reputacionit të markave të mëparshme apo të dëmtojë natyrën dalluese të tyre, apo emrin e mire të markës” pika 4(f) fq.6 e vendimit të Bordit të Apelimeve).

Ne kundërshtuam në Gjykatë këtë qëndrim të paqartë të Bordit të Apelimeve në lidhje me këtë çështje, duke parashtruar se në të dy rastet; si në rastin e shmangies nga të ekzaminuarit të statusin tonë si markë e mirënjohur, apo atë të njohjes së këtij statusi por të mosparimit të kundërshtimit tonë për mungesë të mundësisë për konfuzion, Bordi i Apelimeve në të dy rastet nuk ka aplikuar parashikimet e dispozitës 143 (2) (c) të ligjit “Për Pronësinë Industriale”, pasi duke shmangur të ekzaminuarit e statusin tonë si markë e mirënjohur, Bordi i Apelimeve ka kishte privuar pa të drejtë neve nga mbrojta e ofruar nga dispozita e sipërcituar, apo duke njohur statusin tone si markë e mirënjohur Bordi i Apelimeve përsëri kishte aplikuar keq dispozitën e mësipërme, pasi ai nuk kishte marrë në analizë parashikimet e kësaj dispozite.

Saktësisht, qëndrimi i Bordit të Apelimeve se "Nuk është e nevojshme të provohet se markat e kundërshtuesit janë të mirënjohura dhe për këto arsye gëzojnë një të drejtë të mëparshme", pasi markat e kundërshtuesit janë të regjistruara në territorin Shqiptar dhe kanë një datë depozitim më të hershme se data e depozitimit të markës që kundërshtohet" është totalisht një qëndrim i gabuar, pasi mbrojtja që ligji "Për Pronësinë Industriale" u ofron markave të mirënjohura të regjistruara në Shqipëri dallon qartësisht nga mbrojtja që u jepet markave të mirënjohura të paregjistruara në Shqipëri. Sipas Ligjit "Për Pronësinë Industriale", një markë e mirënjohur jo e regjistruar në Shqipëri mund të kundërshtojë një markë të regjistruar vetëm për shkaqe të mundësisë direkte për konfuzion (kur konsumatori ngatërrohet me njëra tjetrën markat në diskutim - nenet 156/4 dhe 167), kurse një markë e mirënjohur e regjistruar në Shqipëri, siç është dhe rasti në diskutim, ka të drejtë të kundërshtojë një markë edhe nëse marka që kundërshtohet nuk është e ngjashme me markën e mirënjohur, por gjithsesi, ajo çon konsumatorin të besojë se, për shkak të disa ngjashmërive, ka një lidhje midis markave (mundësia indirekte për konfuzion), psh. Kompanitë prodhuese të mallrave (të markave në diskutim) janë të njëjta, apo kompani të lidhura ekonomikisht mes tyre franchising/merchandising etc. (neni 143/2/c).

Kështu që, të përcaktuarit nëse një markë kundërshtuese është e mirënjohur apo jo, ka një rëndësi të madhe pasi kufijtë e mbrojtjes që kjo markë do të gëzojë varen absolutisht nga ky përcaktim. Por ashtu siç u tha më lart, meqenëse Bordi i Apelimeve ishte i paqartë nëse kishte njohur statusin tone si markë e mirënjohur apo jo, e gjitha kjo solli si pasojë mosrespektimin e parashikimeve të nenit 143 (2) (c) të ligjit "Për Pronësinë Industriale" pasi duke shmangur të ekzaminuarit e statusin tonë si markë e mirënjohur, Bordi i Apelimeve na kishte privuar pa të drejtë neve nga mbrojtja e ofruar nga dispozita e sipërcituar, apo duke njohur statusin tone si markë e mirënjohur Bordi i Apelimeve përsëri kishte aplikuar keq dispozitën e mësipërme, pasi ai nuk kishte marrë në analizë parashikimet e kësaj dispozite.

Duke mbajtur parasysh qëndrimin e paqartë të Bordit të Apelimeve të DPPM ndaj çështjes së statusit tonë si markë e mirënjohur, ne depozituam përpara të dyjave gjykatave prova (të reja) të tjera të pakundërshtueshme që provonin statusin tone si markë e mirënjohur, saktësisht: deklaratën e auditit, ku të gjitha të dhënat përkatëse janë të pasqyruara; vendimet e Bordit të Apelimeve nr. 293/12, 294/12 të datës 17.03.2011, dhe nr. 546/16 ku Bordi i Apelimeve të DPPM ka njohur statusin tonë si markë e mirënjohur; si dhe një sërë publikimesh të botuara gjatë vitit 2011, ku marka Red Bull ENERGY DRINK është rradhitur në një nga markat më të mirënjohura në gjithë botën.

Gjatë proceseve gjyqësore, ne bëmë gjithashtu një analizë gjithëpërfshirëse të parashikimeve të dispozitës së sipërpërmendur, duke evidentuar gjithashtu gabimet e Bordit të Apelimeve të DPPM në aplikimin e kësaj dispozite.

Duhet të nënvizohet fakti se figura e demit është një element komplet i sajuar, i rastësishëm, që nuk përmban ndonjë kuptim në lidhje me pijet energjike, dhe për këtë shkak markat Red Bull gëzojnë karakter dallues. Për më tepër ky element ka fituar karakter ekstemisht dallues edhe për shkak të përdorimit të gjerë në treg dhe famës që këto marka kane krijuar prej dekadash. Figura e DEMIT është një nga karakteret dallues të markave të paditësit.

Për shkak të popullaritet të lart paditësi gëzon të drejtën ekskluzive në përdorimin e këtij elementi në lidhje me pijet energjike. Për më tepër, vetë i paditur nuk paraqiti asnjë argument apo prove për të përligjur sadopak përdorimin e figurës së demit (si një element i markës së kontestuar), gjë e cila mund të justifikonte deri diku debatin nëse ne kemi të drejtë të ndalojmë të tjerët në përdorimin e figurës së demit në gjendje statike. Në seancë e datës 14 Janar, 2011 pyetjes së gjykatës se me çfarë motivi përdoret figura e demit pala e paditur nuk ju përgjigje dot, por anashkalojë përgjigjen duke thënë se “pala paditëse nuk ka të drejtë ekskluzive mbi elementin figurë dem por vetëm për mënyrën e stilizimit”.

Nuk është mbajtur parasysh që mallrat e markave janë identike. Markat e kontestuar është regjistruar në klasën 32 për mallrat "pije freskuese jo alkolike" Këto mallra mbulohe nga mallrat e markave Red Bull, dhe për këtë shkak mallrat konsiderohen identike.

Nuk është mbajtur parasysh ngjashmëritë mes markave. Duke krahasuar markat e Red Bull-ti që përmbajnë vetëm figurën e demin (duke venë theksin në markën IR \*\*\* - figura e demit në anën e majtë) me figurën dominues të markës së kundërshtuar, që është demi, duhet të ishte evidentuar se, në të dy markat figurat e demave janë riprodhime reale të demit për sa i takon proporcionit të pjesëve të ndryshme të trupit të demit. Proporcioni i këmbëve, i kurrizit, i qafës, dhe kështu me rradhë janë pothuajse identike. Brinjët duken të kenë të njëjtën gjatësi, përkulje, mprehtësi dhe proporcione. Gjithashtu, proporcionet e kraharorit të fuqishëm dhe relativisht më pak të zhvilluar në pjesën e prapme janë të njëjta.

Të dy figurat e demit janë të ilustruara anash dhe është silueta e demit që duket. Stili grafik i prezantimit ka ngjashmëri të madhe. Qëndrimi i demit nuk ka rëndësi këtu, sepse konsumatori në përgjithësi nuk i kushton vëmendje kësaj, por do ta shohë demin thjesht në lidhje me pijet energjike dhe do mendoj për Red Bull-in. Diferenca midis të ndejturës dhe të vrapuarit nuk neutralizon të gjitha ngjashmëritë e mësipërme.

Elementi fjalë TURBO ka karakter përshkrues dhe si i tillë ai nuk duhet të merret në konsideratë në krahasimin e markave. Gjatë gjykimit sollëm në vëmendjen e gjykatës një sërë argumentash kundër vlerësimit të Bordit të Apelit i cili vlerësonte fjalën TURBO si elementin më dallues të markës së kundërshtuar pasi (sipas Bordit) fjala TURBO nënkupton “ si çdo njëra prej makinave të në të cilën energjia kinetike e një lëngu kthehet në fuqi mekanike nga impulsi ose reaksioni i lëngut”. Kështu që, meqenëse dhe gjykata bie dakort me çfarë ka konkluduar Bordi, ne po paraqesim dhe njëherë argumentat përkatëse:

Nuk është realiste të pranohet se publiku përkatës ka njohuritë e duhura në shkencat mekanike, kështu që, argumenti se konsumatorët, kur të përballen me elementin TURBO, do të mendojnë për "makina me energji kinetike të një lëngu te transformuar në fuqi mekanike nga impulsi ose reaksioni i lëngu' nuk ka gjasa të ndodhë. Nuk mund të mohohet se fjala TURBO përdoret në gjuhën e përditshme si tregues i shpejtësisë dhe energjisë / fuqisë dhe është pikërisht ky kuptim që publiku përkatës i jep. Duke pasur parasysh se markat në konflikt ofrojnë piye energjike, fjala TURBO nuk do të njihet me një kuptim të veçantë, por përkundrazi.

Saktësisht, disa elemente verbalë, zakonisht përdoren për të theksuar karakteristikat e një produkti të caktuar dhe për këtë arsye fillojnë të përdoren në një mënyrë të zakonshme nga prodhues të ndryshëm për të njëjtin qëllim (për të përshkruar indirekt produktin tek

konsumatori). Me fjalë të tjera, termat si; MAX, EXTRA, PLUS, STRONG, LIGHT etj, janë përshkruese. Të përdorura në lidhje me produktin përkatës, këto terma shërbejnë për të informuar konsumatorët mbi karakteristikat e produktit, të veçanta për një produkt të specifik (PEPSI MAX, PEPSI LIGHT - në rritje/ në ulje të nivelit të sheqerit). I njëjti parim vlen edhe për përdorimin e fjalës TURBO në lidhje me energjinë (pijet). Prandaj, për shkak të karakterit përshkrues që elementi TURBO ka, publik përkatës mund të perceptojë TURBO ENERGY DRINK (& figura e demit e vijëzuar me të kuqe) thjesht si një produkt tjetër të paditësit me një efekt më të fortë / më të shpejtë (pije energjike me një shpërthim të fortë). Kështu që, elementi verbal nuk mund të dominojë përshtypjen që aplikimi sjell.

Prandaj, vetëm elementi figurë dem i cili është vendosur dukshëm në qendër të aplikimit, është i vetmi element i dallueshëm në markën e kundërshtuar. Ky është i vetmi element që mundëson identifikimin e origjinës tregtare të produkteve, si një element që do të ketë indikim të fortë mbi konsumatorët dhe do të tërheq vëmendjen e tij, edhe në funksion të faktit se të gjitha elementet verbale të aplikimit kanë karakter jo dallues. Prandaj, kur vlerësojmë ngjashmëritë mes markave, duhet të vlerësojmë markën si një e tërë ku vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet elementit dominues të figurës së demit në markën e kundërshtuar.

Por gjykata, pa asnjë argument, refuzoi të merret në konsiderate arguemetat tona, dhe ashtu sic Bordi vlerëson se elementi fjalë TURBO është pjesa më dominuese e markës të kundërshtuar.

Të gjitha instancat (si gjykatat ashtu dhe Bordi i Apelimeve) dështuan në evidentimin e ngjashmërisë konceptuale.

Stilizimi i markës së kundërshtuar, në vecanti përdorimi i ngjyrës së kuqe që vijëzon figurën e demit rrit mundësinë për konfuzion dhe krahasuar me markën Red Bull ENERGY DRINK të paditësit, nuk mund të mohohet ekzistenca e konceptit identik (Red Bull dhe Red Bull me figurën çift i demash - Demi i vijëzuar me ngjyrë të kuqe). Koncepti identik i markave në konflikt, mundëson krijimin e bashkëlidhjes midis këtyre markave dhe si pasojë shkakton konfuzion.

Në mbështetje të kërkesave të përmendura më lart, ankimuesi (paditësi) solli në vëmendjen e Bordit të Apelimeve dhe Gjykatës shumë vendime gjykatash dhenë nga juridiksione të ndryshme, ku vecanarisht, shtjelloi vendimin e Gjykatës së Distriktit të Hagës, atë të datës 15 Korrik 2009, ku paditësi në mënyrë të suksesshme sfidoi përdorimin e logos së mëposhtme duke u bazuar ndër të tjerash, në markën me figurën e një demi tek.

Marka e kundërshtuar në Gjykatën e Hagës, në shikimin e Gjykatës së Distriktit të Hagës elementi dem në markën e kundërshtuar (e paraqitur më lart) është e ngjashme me markën e Red Bull-it atë të demit të vetëm figurë (Single Bull device). Pra, të dyja rastet kanë si shenjë demin.

Për më tepër, demi është paraqitur në një mënyrë të ngjashme në kuptimin që demi, në të dyja rastet është paraqitur anash dhe stilizuar në mënyrë natyrale. Ndryshimet që mund të gjenden nuk e tejkalojnë mundësinë për konfuzion. Pavarësisht si mund të jenë këto ndryshime, kur arrihet tek ngjashmëria duhet filluar me konsumatorin e zakonshëm të pijeve energjike, i cili nuk i kushton rendësi dallimeve të markave, por e percepton atë si një të vetme. Ju do të shikoni se figura e demit e markës në konfliktin e shqyrtuar nga Gjykata e Hagës është pothuajse identike me figurën e demit të markës së kundërshtuar në procedurën e zhvilluar në Bordin e Apelit, kështu që evidentimet e bëra nga kjo gjykatë duhet të aplikohen dhe për këtë çështje.

Gjithashtu, vendimet e mëposhtme të OHIM konfirmojnë dhe mbështesin pozitën e paditësit.

A. Vendimi i OHIM për kundërshtimin që Red Bull-i ngriti ndaj aplikimit të markës komunitare, nr. \*\*\* BLACK CULT & figura e demit, për klasat 32,39. Vendimi u dha në favor të \*\*\*, kundërshtuesit. OHIM përcaktoi shprehimisht se figura e demit, i cili gjendet në aplikimin e kundërshtuar, është “ një element dominues visual që kapet menjëherë nga syri, për shkak të madhësisë dhe pozicionit të tij në qendër të markës”. Më tej OHIM pohoi që “përkundrazi, elementet fjalë dhe elementë të tjerë vizual të aplikimit të kundërshtuar, nuk janë të mjaftueshme për të siguruar një ndryshim adekuat visual dhe konceptual, për shkak të karakterit thjesht përshkrues të tyre. psh. “Pure Energy” për mallrat në klasën e 32, apo format themelore gjeometrike në ngjyrat.... shenjat që krahasohen janë gjetur për këto arsye të jenë të plotësisht të ngjashme”. Ju lutemi, referohuni ilustrimit më poshtë.

3. Vendimi i OHIM në procedurën e ç’rregjistrimit të markës komunitare ngritur kundër rregjistrimit nr. \*\*\*, OEXTREME XP ENERGY DRINK & figura e demit, rregjistruar në klasat 32, 39. Vendimi u dha në favor të kërkuarit, Red Bull GmbH. OHIM vendosi që markat në konflikt janë konceptualisht dhe vizualisht të ngjashme, pasi ato paraqesin figurën e stilizuar të një demit, pavarësisht se fonetiki nuk janë të ngjashme. Kjo zyrë deklaroi se, bazuar në provat e siguruar, nuk ka asnjë dyshim që marka e mëparshme është një markë me reputacion dhe po ashtu konsumatorët janë jashtëzakonisht të familjarizuar me produktin Red Bull energy drink (pije energjike) të Red Bull-it dhe me fjalën, dhe figurën e Bull (demit). Ju lutemi, referohuni ilustrimit më poshtë:

Marka kundërshtare \*\*\*

Markat kundërshtare \*\*\*

C. Vendimi i Zyrës së Markave të Spanjës, dhenë në procedurën e kundërshtimit ngritur ndaj aplikimit kombëtar spanjoll që i përkiste markës TORITO VOLADOR & figura demit, në klasën 32. Vendimi u dha në favor të ankuesit, \*\*\*, bazuar në faktin që markat e mëparshme kanë të njëjtën paraqitje grafike dhe aspekte konceptuale si aplikimi i kontestuar, e aplikuar gjithashtu për mallra identikë. Ju lutem referohuni ilustrimit si më poshtë.

Të njëjta evidencime duhet të aplikohen dhe në këtë çështje, pasi të dyja markat përmbajnë një prezantim të stilizuar të demit, ekstremisht shumë të ngjashëm, figura e demit është një element që kapet menjëherë nga syri dhe përben elementin dominues, dhe se elementet fjalë dhe elementë të tjerë vizual të aplikimit të kundërshtuar nuk mjaftojnë për bërë dallimin midis shenjave, për shkak të karakterit thjesht përshkrues të tyre.

Për më tepër, konsumatorët përkatës në mënyrë të paevitueshme do të perceptojnë këtë markë si një “BULL” energy drink (pije energjike), dhe si pasojë do të bëjnë një referencë me pijet e famshme energjike të paditësit, \*\*\*.

Për këtë arsye, markat përkojnë plotësisht në nivelin konceptual, të dyja konceptualisht i referohen një demit, pra një kafshë mashkull gjedhi. Ngjashmëria konceptuale vetëm nga shenjat, është e mjaftueshme për të krijuar gjasa (mundësi) për konfuzion në këtë çështje, pasi markat e

mëparshme me figurën e demit, përdoren gjerësisht në Shqipëri dhe si pasojë kanë fituar një reputacion të madh dhe gëzojnë një hapësirë më të gjerë mbrojtje.

4. Nuk u mbajt parasysh shkalla e ulët e vëmendjes së publikun përkatës kur krahasojmë një markë të mëparshme me një të mëvonshme, duhet gjithashtu, të merret në konsideratë shkalla mesatare e vëmendjes së konsumatorit, e cila mund të ndryshojë në varësi të mallrave/shërbimeve që markat ofrojnë.

Kjo qëndrim është mbështetur edhe në vendimin e GJDBE të 22 qershor 1999, dhenë për çështjen C-342/97 Lloyd Schuhfabrik Meyer & Co GmbH v Klijsen Handel BV, ku gjykata shprehimisht thotë (Par. 26) se "Për qëllimin e vlerësimit global për mundësinë për konfuzion, duhet gjithashtu të mbahet parasysh që shkalla mesatare e vëmendjes së konsumatorit ka të ngjarë të ndryshojë në vartësi me kategorinë e mallrave/shërbimeve në fjalë". Nëse ka një nivel të ulët të vëmendjes, dallimet mes markave nuk do të vihen lehtë nga konsumatori dhe për pasojë do të jetë e lehtë për t'i konfuzuar ato.

Në këtë rast, publiku përbëhet, ndër të tjera, nga konsumatorë mesatarë për pije, përfshirë dhe pijet energjike. Dihet se niveli i vëmendjes së konsumatorit mesatar nuk është i lartë me këtë lloj produktesh, për shkak se këto produkte janë produkte që qarkullojnë shpejt me një çmim të ulët. Zakonisht, një konsumator mesatar, për të blerë produkte ushqimore (psh. pije/ apo pijet energjike) vendos brenda disa sekondave dhe, për këtë arsye, është padyshim më e lehtë të çojë konsumatorët në konfuzion, sesa në lidhje me produktet e shtrenjta. Kjo do të thotë se ngjashmëritë midis shenjave do të mbahen më shumë në mendje nga konsumatori sesa dallimet. Kjo çështje është përpunuar në gjykimin e 4 Maj 2005 në çështjen T-22/04, Gesellschaft für Marenkooperation mbH k. OHIM [ËEST k. VVESTLIFE] në paragrafin 34.

Në analizën e të gjithave instancave ky element kaq i rëndësishëm mungon. Asnjëra prej këtyre instancave nuk ka analizuar së paku këtë element, e jo më të të mendohej të mbanin parasysh përfundimet e mësipërme.

Për t'a përmbledhur, në përcaktimin e ekzistencës të mundësisë për konfuzion, marka tregtare duhet të krahasohen duke bërë një vlerësim të gjithanshëm të ngjashmërive mes markave. Krahasimi duhet të bazohet në përshtypjen e përgjithshme që markat krijojnë, duke pasur parasysh, në veçanti, karakterin e tyre dalluese dhe komponentëve dominantë (shih çështjen C-251/95 v BV Sabël Puma AG, Rudolf Dassler Sporti [1997] OJ OHIM 1 / 98, paragrafi 23). Principi kryesor i ndërvarësisë të të gjithë faktorëve është zhvilluar në rastin Canon i 29 shtator 1998 (çështja C- 39/97 Canon [1998] ECR I-5507), ku GJDBE ka përcaktuar se " Në vlerësimin e mundësisë për konfuzion kërkohet të mbahet parasysh të gjithë faktorët përkatës dhe në veçanti, ngjashmëria e mallrave dhe shërbimeve.

Për sa më sipër, bazuar në nenet 472/a dhe 485/d të Kodit të Procedurës Civile,

Kërkojmë nga Gjykata e Lartë:

Të pranoj rekursi për shqyrtim dhe të ndryshojë të dyja vendimet gjyqësore, duke vendosur pranimin e padisë.



## KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoji relacionin përkatës të gjyqtarit Andi Çeliku në seancë gjyqësore, si dëgjoji përfaqësuesen e palës paditëse avokaten \*\*\* e cila kërkoi ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe pranimin e padisë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N

Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore dhe parashtrimet e palëve pjesëmarrëse në gjykim, ka rezultuar se Shoqëria \*\*\* shpk (palë e paditur) ka rregjistruar aplikimin nr. \*\*\*, për markën TURBO ENERGY DRINK, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (pale e paditur).

Shoqëria \*\*\* (pala paditëse), ka kundërshtuar në rrugë administrative, pranë Bordit të Apelit të D.P.P.M, rregjistrimin e aplikimit të mësipërm, duke u mbështetur në statusin si pronar i markave të mëparshme dhe të mirënjohura në Shqipëri, konkretisht markave Red Bull.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.07.2010, Bordi i Apelimeve të D.P.P.M, vendosi të rrëzojë kundërshtimin e Shoqërisë \*\*\*, me argumentin se “...nuk egziston një ngjashmëri e tillë midis markës që kundërshtohet dhe markave Red Bull, që të shkaktojë konfuzion tek konsumatori lidhur me origjinën e mallrave apo mundësinë e bashkëlidhjes së markës që kundërshtohet me këto marka...”.

Pala paditëse, Shoqëria \*\*\*, duke mos qenë dakort me vendimin e sipërcituar të Bordit të Apelit të D.P.P.M, e ka kundërshtuar atë në gjykatë, duke thirrur si të paditur, Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave dhe Shoqërinë \*\*\* shpk.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*, ka rrëzuar padinë e palës paditëse \*\*\*. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\* datë \*\*\*.

Në vendimet e tyre gjykatat e faktit argumentojnë se “...markat ne diskutim nuk krijojnë mundësinë për konfuzion tek publiku i gjerë pasi:- figura e demit në markat kundërshtuese është në pozicion sulmi, kurse në markën e kontestuar në pozicion statik, - figura e demit në markën e kontestuar është dukshëm më e vogël se sa fjala TURBO, e cila nuk ndodhet në markat kundërshtuese, - elementi dallues dhe shumë i dallueshëm i cili nuk gjendet në markat e palës paditëse është fjala TURBO, - ngjyrat e përdorura nga të dy markat janë të ndryshme.

Në lidhje me marrjen e përfitimeve të padrejta nga karakteri dallues i markës së paditësit apo reputacionit të saj, kjo situatë nuk u provua gjatë gjykimit, për shkak se paditësi nuk depozitoi asnjë provë për të vërtetuar uljen e shitjeve apo fitimeve si rezultat i tregtimit të pijeve energjike nën markën TURBO Energy Drink....”.

Kundër vendimeve të mësipërme të gjykatave të faktit, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, pala paditëse, Shoqëria \*\*\*, duke parashtruar shkaqet e përshkruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson se vendimet e gjykatave të faktit janë marrë në interpretim të gabuar të ligjit dhe njëkohësisht janë rrjedhojë e një hetimi të mangët dhe të pjesshëm gjyqësor.

Vendimet gjyqësore, ndaj të cilave është paraqitur rekurs, janë marrë në interpretim të gabuar të nenit 143/2 të ligjit “Për Pronësinë Industriale”. Sipas kësaj dispozite “Një markë nuk duhet të rregjistrohet, ose nëse është rregjistruar, ajo duhet të çregjistrohet, nëse: (c) marka e mëvonshme është identike apo e ngjashme me markën e mëparshme, edhe kur ajo kërkon të rregjistrohet apo është rregjistruar për mallra apo shërbime të cilat nuk janë të ngjashme me ato të markës së mëparshme, kur marka e mëparshme gëzon reputacion në Shqipëri dhe përdorimi apo rregjistrimi i markës së mëvonshme, pa shkak të arsyeshëm, fiton prioritet të padrejtë ose dëmton natyrën dallues apo emrin e mire të markës së mëparshme”.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në referim edhe të kësaj dispozite, çmon se egzistojnë të dhëna të mjaftueshme, të mbështetura në aktet e administruara në gjykim, në lidhje me ngjashmërinë e të dy markave si dhe reputacionin në Shqipëri të markës së mëparshme (Red Bull).

Në të tilla kushte hetimi gjyqësor duhej të ishte përqëndruar dhe thelluar në verifikimin e egzistencës së tre pasojave, që sipas dispozitës mund të sjellë rregjistrimi i markës së mëvonshme TURBO Energy Drink, (1) fitimi i prioritetit të padrejtë (2) dëmtim i natyrës dallues dhe (3) dëmtim i emrit të mirë të markës së mëparshme.

Është e qartë se kështu siç është hartuar dispozita e mësipërme është i mjaftueshëm vërtetimi qoftë dhe vetëm i njëjës prej pasojave të renditura më lart, që marka e mëvonshme të mos rregjistrohet apo nëse është rregjistruar të çregjistrohet.

Nga përmbajtja dhe arsyetimi i vendimeve të gjykatave të faktit, nuk rezulton që të jetë bërë një analizë e hollësishme tre elementeve të cituar më lart, pjesë e dispozitës përkatëse (nenit 143/2) të ligjit “Për Pronësinë Industriale”, duke mos ju dhënë përgjigje pretendimeve të palës paditëse në lidhje me këtë pjesë të hetimit gjyqësor.

Nga ana tjetër, arsyetimin e gjykatave të faktit, se “...nuk u provua marrja e përfitimeve të padrejta, nga i padituri Shoqëria \*\*\* shpk, për shkak se paditësi nuk depozitoi prova në lidhje me uljen e shitjeve apo fitimeve si rezultat i tregtimit të pijeve energjike nën markën TURBO Energy Drink...”, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e konsideron jo vetëm në interpretim të gabuar të nenit 143/2 të ligjit “Për Pronësinë Industriale”, por dhe të pabazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore.

Në këtë pikë, parashtrimet dhe pretendimet e ngritura në ankimet e mëparshme e të përsëritura në rekurs nga pala paditëse, përbënin një detyrim ligjor për tu dhënë përgjigje e për të arsyetuar në lidhje me to, nga ana e gjykatave të faktit.

Po kështu, ndonëse ne dosjen gjyqësore janë të administruara një mori praktikash, si ato të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian, Zyrës së Pronësisë Intelektuale të BE dhe gjykatave shqiptare, vendimet e gjykatave të faktit, ndaj të cilave është paraqitur rekurs, nuk bëjnë një analize të tyre për të konkluduar në një vendimmarrje në përputhje me frymën dhe qëndrimet e konsoliduara që përfaqësojnë ato praktika.

Në këto kushte, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson se duhet të vendoset prishja e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe çështja të dërgohet për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit (tashme kompetente në lënde).

Në rishqyrtimin e çështjes, ajo gjykatë, të marrë në analize dhe kthejë përgjigje të gjitha pretendimeve të palës paditëse si dhe të bëjë verifikimin e egzistencës ose jo të kushteve të kërkuara nga neni 143/2 i ligjit “Për Pronësinë Industriale”, duke arritur në një konkluzion të drejtë për zgjidhjen e këtij konflikti gjyqësor, në përputhje edhe me praktikën e deritanishme gjyqësore.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke u bazuar në nenin 63/c, të Ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 të “Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.

### **V E N D O S I**

Prishjen e vendimit nr. 584, datë 26.03.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Tiranë, më 21.02.2017

## MENDIM PAKICE

Unë gjyqtari në pakicë **Medi BICI**, në bazë të nenit 307/2 të Kodit të Procedurës Civile, parashtroj me shkrim mendimin tim kundër, për t'ia bashkëngjitur vendimit nr. 67, datë 21.02.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili i përket çështjes administrative nr. 01961/2012 regj. them., me palë: paditës \*\*\* dhe të paditura Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave e Shoqëria \*\*\* Shpk, me objekt shpalljen e pavlefshmërisë relative të akteve administrative, etj....

Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes ka rezultuar si më poshtë:

Pala e paditur Shoqëria \*\*\* Shpk ka regjistruar aplikimin nr. \*\*\*, për markën Turbo Energy Drink, pranë palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave. Pala paditëse Shoqëria \*\*\* ka bërë kundërshtim në rrugë administrative, pranë Bordit të Apelimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave për rregjistrimin e aplikimit të mësipërm, duke u mbështetur në statusin si pronar i markave të mëparshme dhe të mirënjohura në Shqipëri, konkretisht i markave Red Bull.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.07.2010, Bordi i Apeliave të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave vendosi të rrëzojë kundërshtimin e palës paditëse Shoqëria \*\*\*, me argumentin se ...nuk ekziston një ngjashmëri e tillë midis markës që kundërshtohet dhe markave Red Bull, në mënyrë që të shkaktojë konfuzion tek konsumatori lidhur me origjinën e mallrave apo mundësinë e bashkëlidhjes së markës që kundërshtohet me markat e tjera. Pala paditëse, duke mos qenë dakord me vendimin e Bordit të Apelimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, e ka kundërshtuar atë në gjykatë, duke thirrur në cilësinë e palës së paditur Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave dhe Shoqërinë \*\*\* Shpk.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\* e ka rrëzuar kërkesëpadinë e palës paditëse \*\*\*. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*. Ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 67, datë 21.02.2017 ka vendosur: Prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë \*\*\* të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ndër të tjera, në vendim shumica arsyeton se: vendimet e gjykatave të faktit janë marrë në interpretim të gabuar të ligjit dhe njëkohësisht janë rrjedhojë e një hetimi të mangët dhe të pjesshëm gjyqësor. Vendimet gjyqësore, ndaj të cilave është paraqitur rekurs, janë marrë në interpretim të gabuar të nenit 143/2 të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale". Sipas kësaj dispozite del se: Një markë nuk duhet të regjistrohet, ose nëse është regjistruar, ajo duhet të ç'regjistrohet, nëse: (c) marka e mëvonshme është identike apo e ngjashme me markën e mëparshme edhe kur ajo kërkon të regjistrohet apo është regjistruar për mallra apo shërbime, të cilat nuk janë të ngjashme me ato të markës së mëparshme, kur marka e mëparshme gëzon reputacion në Shqipëri dhe përdorimi apo regjistrimi i markës së mëvonshme, pa shkak të arsyeshem fiton prioritet të padrejtë ose dëmton natyrën dalluese apo emrin e mirë të markës së mëparshme.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon se ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme, të mbështetura në aktet e administruara në gjykim, në lidhje me ngjashmërinë e dy markave, si dhe reputacionin në Shqipëri të markës së mëparshme (Red Bull). Në të tilla kushte hetimi gjyqësor duhej të ishte përqëndruar dhe thelluar në verifikimin e ekzistencës së tre pasojave, që sipas dispozitës mund të sjellë regjistrimi i markës së mëvonshme TURBO Energy Drink, (1) fitimi i

prioritetit të padrejtë (2) dëmtimi i natyrës dalluese dhe (3) dëmtimi i emrit të mirë të markës së mëparshme.

Në ndryshim nga qëndrimi i shumicës, pakica vlerëson se vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*\* i Gjykatës së Apelit Tiranë është i bazuar në ligj, prandaj si i tillë ai duhej të lihej në fuqi nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Në vendimin nr. \*\*\*, datë 23.07.2010 Bordi i Apelimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave ka rrëzuar ankimin e palës paditëse Shoqëria \*\*\*, me arsyetimin se, nuk ekziston një ngjashmëri e tillë midis markës që kundërshtohet dhe markave Red Bull, që të shkaktojë konfuzion tek konsumatori lidhur me origjinën e mallrave apo mundësinë e bashkëlidhjes së markës që kundërshtohet me këto marka.

Pakica vlerëson se, gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit i kanë marrë të gjitha provat e duhura për zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi, duke arritur në përfundimin se, markat në diskutim nuk krijojnë mundësinë për konfuzion tek publiku i gjerë, pasi figura e *demit* në markat kundërshtuese është në pozicion sulmi, kurse në markën e kontestuar në pozicion statik, figura e *demit* në markën e kontestuar është dukshëm më e vogël se sa fjala Turbo, e cila nuk ndodhet në markat kundërshtuese, elementi dallues dhe shumë i dallueshëm, i cili nuk gjendet në markat e palës paditëse është fjala TURBO, ngjyrat e përdorura nga të dy markat janë të ndryshme.

Sipas pakicës, problemet që ngre Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij kanë të bëjnë me çështjet e ligjit, të cilave ky Kolegj mund tu jepte zgjidhje vetë dhe jo të kthente çështjen për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, pasi nga gjykatat e faktit provat janë marrë dhe analizuar në përputhje të plotë me ligjin procedural.

Argumenti që përdor Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendim se, ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme, të mbështetura në aktet e administruara në gjykim, në lidhje me ngjashmërinë e dy markave, si dhe reputacionin në Shqipëri të markës së mëparshme (Red Bull) jo vetëm që është një konkluzion i pa mbështetur në ligj, por ndikon tek gjykata e rigjykimit në zgjidhjen orientuar të çështjes.

Për sa u thanë më sipër, pakica arrin në përfundimin se, vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është i bazuar në ligj dhe për rrjedhojë ai duhej të lihej në fuqi, prandaj vota ime është kundër vendimit nr. 67, datë 21.02.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Tiranë, më 21.02.2017

GJYQTAR

Medi Bici